

EFEKTI i
DEZINFORMATAVE
dhe **NDIKIMEVE**
të **HUAJA**
në **PROCESET**
DEMOKRATIKE
në **MAQEDONINË E VERIUT**
në vitin 2023



METAMORPHOSIS

Titulli i originalit: „Ефектот на дезинформациите и странските влијанија врз демократските процеси во Северна Македонија во 2023 година“

Botues: Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - “Metamorfozis” – Shkup
Rr. Franklin Ruzvelt nr. 19, Shkup 1000, Maqedonia e Veriut;
metamorphosis.org.mk

Për botuesin: Bardhyl Jashari, Drejtor Ekzekutiv, Fondacioni “Metamorfozis”

Redaktorë: Filip Stojanovski dhe Dançe Danillovska-Bajdevska

Hulumtues: Gjorgji Mitrevski

Realizimi i anketës: Agjencia “Rejting”

**Përkthimi nga
Maqedonishtja në Shqip:** Bestel - Qendra e gjuhëve

Dizajni: Brigada dizajn
Shkup, 2024

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје
316.776.23:321.7(497.7)“2023”(047.31)
327.8:321.7(497.7)“2023”(047.31)

EFEKTI I dezinformatave dhe ndikimeve te huaja në proceset demokratike në Maqedoninë e Veriut në vitin2023 [Електронски извор] / [redaktorë Filip Stojanovski dhe Dançe Danillovska-Bajdevska ; hulumtues Gjorgji Mitrevski]. - Shkup : Fondacioni për internet dhe shoqëri Metamorfozis, 2024

Начин на пристапување (URL):

https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2024/01/efektot-na-dezinformaciite-05_al.pdf.

- Превод на делото: Ефектот на дезинформациите и странските влијанија врз демократските процеси во Северна Македонија во 2023 година. - Текст во PDF Формат, содржи 34 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 01.02.2024. - Фусноти кон текстот. - Содржи и:

Aneksi

ISBN 978-608-263-115-8

а) Дезинформации – Влијание – Демократија – Македонија – 2023 – Истражувања б) Странска пропаганда – Влијание – Демократија – Македонија – 2023 – Истражувања

COBISS.MK-ID 62883333



Hulumtimi është realizuar në kuadër të projektit “Ngritja e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile, mediave dhe gazetarëve përmes trajnimeve, duke u mundësuar atyre të përmirësojnë aftësitë e tyre për njohjen dhe raportimin e ndikimit malinj të huaj përmes mediave në sferat kyçe të shoqërisë”, i cili implementohet nga Fondacioni për Internet dhe Shoqëri “Metamorfozis” - Shkup me mbështetjen e IFEX - Rrjeti Global për Promovimin dhe Mbrojtjen e Lirisë së Shprehjes (IFEX - The Global Network Promoting and Defending Free Expression). Përmbajtja është përgjegjësi e Fondacionit për Internet dhe Shoqëri Metamorfozis - Shkup dhe nuk i pasqyron gjithmonë pikëpamjet e IFEX-it.

Licenca: Përmbajtjet e këtij botimi janë publikuar nën licencën “Creative Commons: Thekso burimin” <https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/> – lejohet ndarja, kopjimi dhe rishpërndarja e tyre, si dhe përshtatja, me kushtin e vetëm që të theksohet burimi dhe botuesit

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
REZYME E GJETJEVE KRYESORE	5
PASQYRË E NARRATIVEVE TË DEZINFORMATAVE NË MEDIA	8
HULUMTIMI I OPINIONIT PUBLIK	11
QËLLIMET E HULUMTIMIT TË OPINIONIT PUBLIK	11
ANALIZA E REZULTATEVE NGA HULUMTIMI I OPINIONIT PUBLIK	11
PËRHAPJA E DEZINFORMATAVE	11
INTERESI PËR NDRYSHIME TË POLITIKËS	16
NDIKIMI I BURIMEVE TË HUAJA DHE VENDORE TË DEZINFORMATAVE	22
NDIKIMI I NARRATIVEVE TË DEZINFORMATAVE PRO-RUSE	24
MARRËDHËNIET GJEOPOLITIKE TË MAQEDONISË SË VERIUT	27
REKOMANDIME	31
ANEKSI: METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	33
METODOLOGJIA E MONITORIMIT TË NARRATIVEVE DEZINFORMUESE NË MEDIA	33
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT TË OPINIONIT PUBLIK	33
DEMOGRAFIA E TË ANKETUARVE	34

HYRJE

Në vitin 2023, krijimi dhe përhapja e dezinformatave janë identifikuar jo vetëm si problem mediatik, por edhe si problem sigurie, i cili e prish funksionimin e institucioneve demokratike dhe sferën mediatike, duke shkaktuar rreziqe të mëdha për të gjithë shoqërinë, duke kërcënuar të drejtat themelore të njeriut - nga siguria personale dhe shëndeti deri te të gjitha llojet e lirive. Pas pushtimit të plotë rus të Ukrainës në vitin 2021, pati një ndryshim global në perceptimin mbi rëndësinë e këtij problemi, i cili më parë ishte injoruar ose minimizuar. Fatkeqësisht, investimet masive të aktorëve antidemokratikë kanë vazhduar të forcojnë ndikimin e dezinformatave, së bashku me teoritë e konspiracionit dhe llojet e ndryshme të propagandave dhe manipulimeve politike.

Hulumtimi “Efekti i dezinformatave dhe ndikimet e huaja në proceset demokratike në Maqedoninë e Veriut në vitin 2023” është realizuar me qëllim të përcaktimit të shkallës së ekspozimit dhe ndikimit të dezinformatave te qytetarët në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke i kombinuar analizat e karakteristikave të qarkullimit të dezinformatave me një anketë të kryer në një mostër përfaqësuese në nivel kombëtar. Metodologjia e aplikuar mundëson krahasimin me rezultatet e hulumtimeve të mëparshme të të njëjtit lloj, ndër të cilat edhe anketa komplementare e realizuar në vitin 2021, që ofron njohuri për trendet si bazë për përcaktimin e prioritetëve, të transferuara dhe në formë rekomandimesh në drejtim të qasjes me angazhimin e gjithë shoqërisë (ang. whole society approach) me të cilën kërkohen zgjidhje për shkaqet strukturore të ndjeshmërisë ndaj dezinformatave. Njëkohësisht, rezultatet e këtij hulumtimi do të shërbejnë drejtpërdrejt në procesin e krijimit të një Strategjie kombëtare për ndërtimin e rezistencës shoqërore ndaj efekteve të dëmshme të dezinformatave, të cilën, me iniciativën e shoqërisë civile, Qeveria e mori përsipër ta përfshijë në Programin e punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024.

Dizajni i këtij hulumtimi u orientua nga pikëpamja se vetëm përmes vëzhgimit empirik mund të arrihet të kuptohet situata reale, si bazë për punë solide gazetareske për të demistifikuar narrativet dezinformuese-populiste të pranuar gjerësisht që nxisin apatinë, sipas të cilave “të gjithë janë të njëjtë” dhe, për këtë arsye, nuk ka kuptim të kërkojmë demokraci.

Fondacioni Metamorphosis e realizoi këtë hulumtim me mbështetjen e Rrjetit Global për Mbrojtjen dhe Promovimin e Shprehjes së Lirë IFEX, si pjesë e një përpjekjeje gjithëpërfshirëse që synon zbulimin e ndikimit të propagandës së huaj në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe përmes edukimit publik për të përforcuar kapacitetet e palëve kryesore të përfshira (organizatat civile dhe aktivistët, mediat dhe gazetarët, institucionet shtetërore dhe vendimmarrësit) në mënyrë që ata të mund të marrin pjesë aktive në ndërtimin e rezistencës ndaj ndikimeve të dëmshme antidemokratike.

¹ Efekti i dezinformatave dhe ndikimet e huaja në proceset demokratike në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022; <https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2022/05/istrazuvanje-mk-v07.pdf>

REZYME E GJETJEVE KRYESORE

Hulumtimi tregon një ndryshim domethënës në shprehinë e informimit të qytetarëve, në krahasim me vitin e kaluar 2022. Informimi përmes kontakteve dhe komunikimeve personale ka shënuar një rritje të jashtëzakonshme gjatë vitit të fundit. Nëse vitin e kaluar vetëm 36% e qytetarëve janë informuar çdo ditë për zhvillimet dhe ngjarjet përmes komunikimit të drejtpërdrejtë në marrëdhëniet e tyre personale, këtë vit kjo përqindje është rritur në 64% dhe e tejkalon madje edhe përqindjen e qytetarëve që informohen nga televizionet vendore. Nga kanalet mediatike të informacionit, më të përfaqësuara janë televizionet vendore (61%), të ndjekura nga mediat sociale (58%). Ka një ndryshim të dukshëm në krahasim me vitin e kaluar me portalet e internetit - vitin e kaluar 37% kanë marrë informacione nga portalet e internetit, ndërsa këtë vit kjo përqindje është madje 51%.

Me përjashtim të stacioneve televizive vendore, që i nënshtrohen rregullores dhe Facebook-ut, i cili ka program për verifikimin e fakteve, të gjitha kanalet e tjera mediatike nga të cilat qytetarët informohen çdo ditë, nuk kanë asnjë politikë për t'u mbrojtur nga dezinformatat. Portalet e internetit, ndonëse duhet të respektojnë Kodin e Gazetarëve dhe disa kushte për t'u bërë pjesë e familjes vetërregulluese, në realitet, nuk e bëjnë këtë. Përveç kësaj, numri i portaleve të internetit në Regjistrin e Mediave Profesionale është dukshëm më i vogël se numri i portaleve aktive. Kësaj duhet shtuar fakti se qytetarët informohen edhe nga portalet e internetit nga vendet fqinje (nga ku vjen numri më i madh i dezinformatave) dhe për të cilat nuk ka fare evidencë në vendin tonë.

Duke marrë parasysh këtë situatë, nuk na habit fakti që përqindja më e madhe e qytetarëve kanë besim të plotë në informacionet që i marrin nga kontaktet personale (24%), ndërsa në stacionet televizive vendore, si kanal mediatik më shpesh i përdorur, vetëm 4% kanë besim të plotë. Informacionet e marra nga portalet e internetit dhe mediat sociale është plotësisht i besueshëm për më pak se 2% që tregon se, qytetarët edhe pse informohen çdo ditë nga këto media, kanë shumë pak besim tek ato. Duket sikur qytetarët kanë krijuar një qëndrim se mediave nuk duhet t'u besohet. Paragjykimet e tilla të qytetarëve e vështirësojnë detyrën e mediave profesionale për informimin e drejtë për ngjarjet brenda dhe jashtë vendit, si dhe mundëson hapësirë për përhapjen e lehtë të dezinformatave.

Qytetarët janë të vetëdijshëm se dezinformatat paraqesin problem serioz në vendin tonë – rreth 83% e ndajnë këtë mendim. Një përqindje e lartë e qytetarëve, 42%, janë prononcuar se vetëm gjatë një jave vërejnë storje krejtësisht të trilluara për qëllime dhe agjenda politike të caktuara në mediat nga të cilat informohen - gjë që tregon se një përqindje e madhe e qytetarëve janë të vetëdijshëm dhe për çfarë qëllimesh shfrytëzohen dezinformatat.

Qytetarët gjithashtu e kuptojnë mirë natyrën e dezinformatave – madje 75% konsiderojnë se dezinformatat e inkurajojnë gjuhën e urrejtjes dhe ndarjet në shoqëri, kurse 68% pajtohen se dezinformatat janë një kërcënim për sigurinë. Gjatë kësaj, përqindja më e madhe e qytetarëve (pothuajse 40%) konsiderojnë se shteti nuk ka kapacitet për t'u përballur me kërcënimet nga dezinformatat dhe format e tjera të luftës speciale. Megjithatë, madje tre të katërtat e qytetarëve (75%) pajtohen me pohimin se dezinformatat duhet të sanksionohen me ligj, kurse një përqindje akoma më e madhe (87%) presin që Qeveria të ndërmarrë masa për t'u ballafaquar me dezinformatat në vend.

Këto të dhëna tregojnë qartë se është e nevojshme që institucionet shtetërore nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv të marrin një rol më proaktiv në përforcimin e kapaciteteve të mediave dhe të iniciojnë një proces për krijimin e një strategjie shtetërore për të luftuar dezinformatat, me qëllim mbrojtjen e qytetarëve nga efektet e dëmshme të dezinformatave. Kjo nevojë është identifikuar edhe në hulumtimin e vitit të kaluar, i cili ka rezultuar me të njëjtin rekomandim dhe mbetet prioritet, sidomos për shkak se një përqindje e madhe e qytetarëve konsiderojnë se shteti nuk ka kapacitete për t'u përballur me kërcënimet nga dezinformatat (pothuajse 40%). Ndërkohë, pas iniciativës së një grupi të organizatave të shoqërisë civile², Qeveria e RMV-së mori përsipër obligimin³ për krijimin e një Strategjie Kombëtare për Ndërtimin e Rezistencës Shoqërore ndaj Efekteve të Dëmshme të Dezinformatave, si pjesë e Programit Vjetor të Punës në vitin 2024.

Duket se mosbesimi i përgjithshëm në institucionet e shtetit nga njëra anë dhe, mosbesimi në media nga ana tjetër,

² Rekomandime për veprim të përbashkët për të ndërtuar rezistencën e shoqërisë ndaj efekteve të dëmshme të dezinformatave; https://metamorphosis.org.mk/izdanija_arhiva/preporaki-za-zaednichka-akcija-za-gradenje-opshtestvena-otpornost-kon-shtetnite-vlijanija-na-dezinformaciite/

³ Shkresë nga Ministria e Drejtësisë së RMV-së nr. 10-2584/2, datë 19.10.2023, drejtuar Sekretariatit të Përgjithshëm të RMV-së.

vetëm se e ushqejnë tezën e dezinformimit sipas së cilës të gjithë aktorët politikë, pa përjashtim, pak a shumë përhapin dezinformata. Kështu që, kur i pyetëm qytetarët përmes cilëve aktorë përhapen dezinformatat, një përqindje e barabartë e qytetarëve vlerësonin se diplomacia dhe shërbimi i Federatës Ruse, si dhe diplomacia dhe shërbimet e BE-së dhe të SHBA-ve, përhapin dezinformata (rreth 48%). Rezultatet e hulumtimit nxjerrin në përfundimin se narrativet e dezinformatave në media, të cilat përdoren për t'i paraqitur BE-në dhe SHBA-në plotësisht të njëjta, ose jo më të mira se Rusia, kanë ushtruar dukshëm njëfarë ndikimi në perceptimin e qytetarëve.

Qytetarët, në një masë të madhe, bien pre e dezinformatave dhe teorive konspirative. Këtë e konfirmojnë edhe gjetjet e hulumtimit, ku u shënua një përqindje e lartë e qytetarëve që besojnë në narrativet e dezinformatave. Kështu, rreth 62% e qytetarëve besojnë se “Globalistët apo elitistët i kontrollojnë ngjarjet në botë”, ndërsa 66% e qytetarëve besojnë se “COVID-19 është krijuar qëllimisht”. Kishte edhe dezinformata kundër vaksinimit - 28% e qytetarëve besojnë se “sëmundjet për të cilat kryhet vaksinimi mund të mposhten me imunitet natyror”.

Kur është fjala për dezinformatat në lidhje me NATO-n, te qytetarët ende mbizotëron mendimi se Rusia ka një fuqi më të madhe ushtarake. Kjo për shkak të dezinformatave të përsëritura prej kohësh që, pavarësisht nëse ngjall frikë apo admirim ndaj Rusisë, nuk dështon kurrë ta nxjerrë në pah atë si një superfuqi që edhe NATO-ja duhet t'i frikësohet. Narrativet dezinformuese se “Lufta në Ukrainë është në të vërtetë një luftë midis Rusisë dhe NATO-s” dhe se “Në Ukrainë ekzistojnë laboratorë amerikanë të armëve biologjike” janë narrative që qytetarët besojnë e që vijnë nga makina e propagandës ruse së bashku me narrativen se “Rusia udhëheq luftë kundër nazizmit në Ukrainë”. Në të gjitha këto narrative, kishte një përqindje më të lartë të qytetarëve që besojnë, kundrejt atyre që nuk besojnë, gjë që na tregon suksesin e dezinformatave nga Rusia ndaj një grupi të caktuar qytetarësh që prirën ta besojnë atë. Edhe pse hulumtimi tregon se narrativet pro-ruse kanë një përhapje të madhe në hapësirën mediatike, 30% e qytetarëve konsiderojnë se në vend nuk ka subjekte që promovojnë interesat ruse. Është edhe më e rëndësishme të përmendet se edhe 50% e qytetarëve nuk kanë mendim të tyre për këtë çështje. Në vend mungon vetëdija për ekzistencën e etniteteve që i promovojnë interesat ruse dhe, për më tepër, partitë politike ndërmarrin aktivitete që haptazi ose fshehurazi komplotojnë për t'u larguar nga kursi i integritimit në BE dhe anëtarësimit në NATO, në dobi të lidhjes së aleancës me Rusinë. Në këtë drejtim, mediat dhe rrjetet e ndikimit që përhapin narrative pro-ruse ose anti-ukrainase dhe anti-BE dhe anti-NATO nuk janë identifikuar si eksponentë të Kremlinit.

Pikëpamjet e qytetarëve për proceset e euro integritimeve në BE nuk kanë ndryshuar dukshëm, në krahasim me vitin e kaluar. Përqindja më e lartë e qytetarëve (48%) kanë konsideruar se vendi duhet të bëhet anëtar i BE-së, por pa lëshime ndaj Bullgarisë. Një përqindje akoma më e lartë (50%) nuk pajtohen me idenë e ndryshimit të kushtetutës, me synimin për hyrjen e vendit në BE.

Në narrativet dezinformuese për humbjen e vlerave tradicionale familjare që do të sjellë anëtarësimi në BE besojnë 39% e qytetarëve, gjë që tregon se sulmet dezinformuese ndaj BE-së dhe NATO-s kanë ndikim në besimin tashmë të thyer në vlerat perëndimore dhe BE. Për këtë flet edhe rënia e ndjenjës së sigurisë së qytetarëve që sjell anëtarësimi në NATO. Nëse vitin e kaluar 40% e qytetarëve ndiheshin më të sigurt për shkak të anëtarësimit të vendit në NATO, këtë vit kjo përqindje ka rënë në 30%.

Dezinformatat që synojnë ta paraqesin Rusinë si një alternativë të BE-së, po ashtu kanë luajtur një rol në perceptimin e qytetarëve. Kështu, 35% e qytetarëve vlerësojnë se një aleancë me një fuqi të madhe sllave dhe ortodokse si Rusia është më e dobishme për vendin tonë. Mendim të kundërt paraqesin vetëm 26% e qytetarëve. 42% e qytetarëve mendojnë se vendosja e sanksioneve ndaj Rusisë nuk është një politikë e mirë për vendin tonë, gjë që është vetëm një konfirmim i prezencës së narrativeve dezinformuese në media që synojnë të theksojnë lidhjen e vendit tonë me Rusinë, si dhe për të vënë në pah se miqësia me një forcë kaq të fuqishme është në interes të vendit tonë.

Qytetarët kanë mendim të ndarë për ndikimin e Rusisë në vendin tonë - 34% janë të mendimit se Rusia ka ndikim pozitiv, ndërsa një përqindje pak më e madhe (38%) deklarojnë se Rusia ka ndikim negativ. I ngjashëm është edhe rasti me SHBA-të, ku shohim një opinion të ndarë - 39% besojnë se SHBA-të kanë ndikim pozitiv, ndërsa 37% mendojnë se kanë ndikim negativ në vendin tonë.

Me përjashtim të Serbisë, të gjitha vendet fqinje, sipas mendimit të qytetarëve, kanë ndikim negativ dominues në vendin tonë. Serbia, nga ana tjetër, konsiderohet vendi me ndikimin më të madh pozitiv në vendin tonë. Përveç bazës historike për një përjetim të tillë të Serbisë, fakti që nuk ka barrierë gjuhësore, u mundëson qytetarëve maqedonas një pasqyrë të lehtë dhe të rregullt të ngjarjeve në sferën shoqërore serbe. Kjo, natyrisht, ofron një kanal të hapur të drejtpërdrejtë për përhapjen e dezinformatave që tashmë janë të pranishme në hapësirën mediatike serbe. Aktivitetet e verifikimit të fakteve konfirmojnë qartë se numri më i madh i dezinformatave pro-ruse për qytetarët maqedonas vijnë pikërisht përmes tabloideve serbe. Prania e narrativeve pro-ruse është e lartë, sepse Serbia është një vend që ende nuk ka vendosur sanksione kundër Rusisë, ndër të tjera duke mundësuar edhe mediat shtetërore ruse të veprojnë në vend në gjuhën

lokale, kështu që narrativet dezinformuese ruse përhapen lirshëm te qytetarët tanë përmes mediave serbe. Për më tepër që qytetarët janë më të prirë t'i besojnë një burimi mediatik që vjen nga një vend që ata besojnë se ka ndikimin më pozitiv për vendin tonë. Nga ana tjetër, qytetarët e neglizhojnë ose nuk janë të vetëdijshëm për faktin se Rusia e ka shpallur zyrtarisht Republikën e Maqedonisë së Veriut si "shtet armik" në vitin 2022. Për më tepër, në qëndrimet e qytetarëve tanë ndaj Rusisë ndikon edhe fakti që Serbia, si vendi që një përqindje e madhe e të anketuarve e konsiderojnë si më miqësoren, bashkëpunon me Rusinë, gjë që lidhet me narrativet se politika e saj e jashtme është shembull për t'u ndjekur.

Qytetarët e anketuar vlerësojnë se Bullgaria ka ndikimin më negativ në vendin tonë - 77% e tyre janë të këtij qëndrimi.

Zbrazëtirat informative ofrojnë gjithashtu hapësirë për veprimin e ndikimeve të jashtme malinje në perceptimin e qytetarëve. Shumica e qytetarëve nuk kanë mendim për sistemin politik kinez (më shumë se 40%) dhe nuk kanë një qëndrim të qartë për ndikimin e Kinës në vendin tonë. Nëse marrim parasysh se informacionet për investimet kineze dhe bashkëpunimin ekonomik me Kinën janë të pranishme kryesisht në media, vërejmë një hapësirë për të krijuar një perceptim të ndikimit pozitiv të Kinës, duke neglizhuar faktin se edhe investimet kineze në vend mund të luajnë një ndikim negativ, veçanërisht nëse dihet fakti që bashkëpunimi me Kinën mund të kërkojë procedura që nuk përshtaten me vlerat, rregullat apo procedurat e BE-së.

Ndikimet e jashtme armiqësore, përveç atyre politike dhe ekonomike, përdorin edhe fushata dezinformuese dhe propagandë përmes së cilave i ndryshojnë perceptimet e qytetarëve për të promovuar interesat e tyre gjeopolitike. Këtë mund ta shohim më qartë përmes numrit të madh të qytetarëve që besojnë në narrativet e dezinformatave që synojnë ta paraqesin Rusinë si një alternativë ndaj BE-së dhe, në kurriz të kësaj, për të rrënjosur besimin në Perëndim dhe në procesin e integritimit evropian. Përhapja e madhe e narrativeve pro-ruse dhe sasia e madhe e dezinformatave që mund të gjenden në media çdo ditë krijojnë një perceptim te qytetarët se nuk ka ndonjë dallim të madh midis Rusisë dhe SHBA-ve. Qytetarët besojnë se Qeveria e Rusisë mban përgjegjësi për pushtimin e Ukrainës dhe nuk e arsyetojnë sulmin rus ndaj Ukrainës. Megjithatë, ata, gjithashtu, besojnë në narrativet pro-ruse që synojnë të anashkalojnë një pjesë të përgjegjësisë për luftën të SHBA-të (si, për shembull, ekzistenca e bio-laboratorëve amerikanë në Ukrainë). Narrativet e këtilla janë shumë të rrezikshme për demokracinë tashmë të ndjeshme në vend dhe kanë kapacitetin t'i shkaktojnë dëme të mëdha. Duke i ndryshuar perceptimet e qytetarëve, ndikimet e huaja i ndryshojnë edhe bindjet gjeopolitike të qytetarëve për drejtimin në të cilin duhet të lëvizë vendi.


PASQYRË E NARRATIVEVE TË DEZINFORMATAVE NË MEDIA

Dezinformatat, si një çështje madhore globale, kanë një ndikim veçanërisht negativ në demokracinë e brishtë të Maqedonisë së Veriut, por edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor. Ndikimet e huaja malinje i përdorin dezinformatat dhe manipulimet mediatike si mjet për të shkaktuar polarizim dhe konfuzion. Hiperprodhimi i narrativeve të ndryshme dezinformuese, veçanërisht në lidhje me agresionin rus kundër Ukrainës, vazhdon të dëmtojë kohezionin social dhe zhvillimin demokratik në vend. Këto narrative ndryshojnë vazhdimisht, por kanë një qëllim: të rrënojnë ndjenjat antidemokratike dhe anti-perëndimore, të gjitha me synimin për të riorientuar politikën e vendit sa më larg nga Bashkimi Europian (BE) dhe NATO-ja. Për ta arritur këtë, aktorët malinje i shfrytëzojnë ngjarjet kryesore politike dhe shoqërore si zgjedhjet, referendimet dhe pandemitë për të promovuar dezinformimin dhe narrativet shoqërore në mbështetje të qëllimeve të tyre ideologjike dhe gjeopolitike⁴.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë të ekspozimit të qytetarëve ndaj përmbajtjeve dezinformative, dhe, përmes kësaj, për të kuptuar disa ndryshime në qëndrimet e qytetarëve të vërejtura gjatë analizës krahasuese të gjetjeve të anketave të opinionit publik në vitin 2022 dhe 2023, është bërë një pasqyrë e temave më të përfaqësuara dezinformuese, respektivisht përmbajtjeve dezinformuese në sferën mediatike maqedonase në periudhën janar - shtator 2023, të cilat janë të disponueshme në raportet tremujore të monitorimit të mediave me fokus Maqedoninë e Veriut⁵.

Në Grafikun e mëposhtëm janë paraqitur temat e mediave më shpesh të përfaqësuara rreth të cilave janë grupuar narrativet e dezinformative në periudhën e monitoruar.

Numri i artikujve për çdo temë dezinformuese
periudha 2022-2023



⁴ Geopolitical perspective of disinformation flows in the Western Balkans; https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2023/06/geopolitical_perspective_of_disinformation_flows_in_the_western-balkans_2022-6-1.pdf

⁵ Disinformation trends and narratives in the Western Balkans media monitoring report for the period January - March 2023; <https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2023/04/metamorfozis-dezinformatcii-i-narativi-januari-mart-2023-za-web-1.pdf>
Disinformation trends and narratives in the Western Balkans media monitoring report for the period April - June 2023; <https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2023/07/media-monitoring-april-june-2023-18.pdf>
Disinformation trends and narratives in the Western Balkans media monitoring report for the period July - September 2023; <https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2023/10/media-monitoring-july-september-2023-13.pdf>

Tema më e përfaqësuar mediatike rreth së cilës u plasuan numri më i madh i dezinformatave ishte lufta në Ukrainë. Që nga fillimi i agresionit rus në Ukrainë, në media qarkullojnë vazhdimisht dezinformata që kanë tendencë të arsyetojnë agresionin rus. Derisa narrativet specifike ndryshojnë, përhapja e dezinformatave mbetet e njëjtë. Narrativet më të zakonshme mbi këtë temë ishin si vijon:

- ✎ Lufta në Ukrainë është një luftë mes NATO-s dhe Rusisë
- ✎ Rusia nuk po bën luftë në Ukrainë, po kryen vetëm një operacion special
- ✎ Rusia po lufton nazizmin në Ukrainë
- ✎ Ukraina rekruton fëmijë në front
- ✎ Tregtia e organeve në Ukrainë
- ✎ Ukraina shet në tregun e zi ndihma ushtarake të dhuruara

Të gjitha këto narrative e portretizojnë Ukrainën në dritën më të keqe të mundshme si të dobët dhe të korruptuar kundër Rusisë - e cila është superiore dhe e fuqishme dhe synojnë të rrënojnë besimin e qytetarëve në vendimet e shtetit për të ndihmuar dhe mbështetur Ukrainën.

Narrativet anti-perëndimore në vend po i ndërlidhen propagandës ruse. Një nga shenjat dalluese të propagandës së Kremlinit janë luftërat kulturore, të cilat nxjerrin në pah përçarjen në shoqëritë perëndimore kur merren me çështje të mosmarrëveshjeve shoqërore dhe polarizimit. Kjo lloj propagande dhe dezinformatat e paraqesin "Perëndimin", respektivisht demokracinë perëndimore si vende që në zgjidhjen e çështjeve shoqërore i braktisin vlerat tradicionale dhe nuk udhëhiqen nga parimet morale dhe, si të tilla, i vendosen si të kundërta të rendit shoqëror rus që i parapëlqen vlerat tradicionale, respektivisht vlerat "e rregullta". Të njëjtat narrative mbizotërojnë edhe në vendet e Ballkanit dhe, për këtë arsye, mund të jenë të pjekura për eksploitim të dezinformatave duke rregulluar në mënyrë të pandershme kontekstin në të cilin ato shprehen. Narrativi më i zakonshëm këtu është "Perëndimi i shkatërron familjet, identitetin kulturor dhe kombëtar, praktikon perversion dhe abuzime ndaj fëmijëve, përfshirë edhe pedofilinë, dhe e gjithë kjo është shpallur si normale në jetën e tyre".

Narrativet e ndryshme të dezinformatave lidhur me integrimin në BE, edhe pse mjaft të pranishme në periudhën e monitoruar, u bënë më të pranishme pas vendimit të Bullgarisë për të vendosur veto për fillimin e negociatave për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut. Narrativet dezinformuese që, nga njëra anë e portretizojnë BE-në si "përkrahëse të sjelljes antidemokratike dhe fashiste midis vendeve anëtare" dhe nga ana tjetër theksojnë se "anëtarësimi në BE do të thotë humbje identiteti" synojnë të krijojnë pakënaqësi ndaj BE-së dhe paraqesin alternativa të tjera anti-europiane për vendin. Dezinformatat që e problematizojnë humbjen e identitetit, përveçse krijojnë frikë, po ashtu e polarizojnë edhe publikun dhe e promovojnë Rusinë si një vend mik që mund të ndihmojë Maqedoninë e Veriut. Narrativet më të zakonshme kundër BE-së që u vërejtën në periudhën e monitoruar ishin:

- ✎ BE-ja realisht nuk dëshiron që Maqedonia e Veriut të jetë pjesë e Unionit
- ✎ BE-ja po e shantazon dhe gënjen Maqedoninë e Veriut
- ✎ Është më mirë që Maqedonia e Veriut të anëtarësohet në BRICS sesa në BE
- ✎ Për Maqedoninë e Veriut, është më mirë të jetë me Rusinë në vend të BE-së
- ✎ Hyrja në BE do të thotë humbje e identitetit

Dezinformatat në lidhje me komunitetin LGBT përdoren më së shumti për sulme ndaj BE-së ose Perëndimit, dhe një pjesë më e vogël e tyre i ndërlidhen narrativit pro-rus për ruajtjen e shoqërive tradicionale dhe religjionit. Shumica e artikujve dominohen nga narrativi se detyrë është mbrojtja e familjes dhe fëmijëve, duke krijuar kështu një panik moral të bazuar në gjuhën e urrejtjes dhe dezinformatave. Narrativet më të përfaqësuara në këtë drejtim ishin:

- ✎ Vendet europiane janë të sëmurë, sepse njerëzit atje i mbështesin vlerat e LGBT
- ✎ Komuniteti LGBT është një kërcënim për mënyrën tradicionale të jetesës
- ✎ BE-ja së bashku me komunitetin LGBT e promovojnë pedofilinë

Këto narrative dezinformuese shpesh ndiqen nga lëvizje anti-gjinore, të cilat kundërshtojnë parimin e barazisë gjinore, kundërshtojnë partneritetet e të njëjtës gjini dhe të drejtat e personave transgjitorë dhe, në instancë të fundit, i plotësojnë dhe i përforcojnë narrativet anti-LGBT.

Me përfundimin e pandemisë COVID-19, plasimi i dezinformatave në lidhje me vetë pandeminë është ulur në mënyrë drastike, por është rritur numri i narrativeve kundër vaksinimit që synojnë të vështirësojnë procesin e imunizimit të popullatës. Këto narrative dezinformuese krijojnë frikën nga vaksinimi, duke shkaktuar dëme të mëdha jo vetëm për qytetarët, por edhe për shëndetin publik. Më shqetësues është ndikimi që këto narrative kanë në reduktimin e imunizimit të fëmijëve. Narrativet më të zakonshme kundër vaksinimit në periudhën e monitoruar ishin:

- 👉 Vaksinat janë një agjendë për shpopullimin e popullsisë
- 👉 Vaksinat shkaktojnë kancer
- 👉 Vaksinat ndikojnë në fertilitet dhe shkaktojnë sterilitet
- 👉 Vaksinat shkaktojnë autizëm
- 👉 Vaksinat janë helmuese, të pasigurta, eksperimentale dhe nuk mbrojnë

Teoritë e konspiracionit nënkuptojnë ekzistimin e një grupi të vogël njerëzish të fuqishëm që planifikojnë fshehurazi aktivitete të paligjshme dhe të liga që ndikojnë në rrjedhën e ngjarjeve. Teoritë e konspiracionit, zakonisht, nuk mbështeten në prova që mund t'i rezistojnë verifikimit kritik, por kjo nuk i pengon ato të përhapen shpejt. Pavarësisht nëse bëhet fjalë për agresionin rus kundër Ukrainës, apo pandeminë, sulmet ndaj BE-së apo ndaj Perëndimit, teoritë e konspiracionit janë të dëmshme për shoqërinë në një sërë mënyrash. Narrativet më të zakonshme që dalin nga këto teori, e që ishin të pranishme në sferën mediatike maqedonase gjatë periudhës së monitoruar, janë:

- 👉 “Chemtrails” – e ashtuquajtura “spërkatje” e vendbanimit
- 👉 Teoria konspirative e rrjetit 5G
- 👉 Pas pandemisë, në skenën botërore do të shfaqet një “rend i ri botëror”.
- 👉 NATO dhe Perëndimi janë krijuesit e Satanizmit
- 👉 Në vaksina vendosen çipa

Të gjitha këto narrative dezinformuese i shfrytëzojnë zhvillimet e rëndësishme shoqërore dhe synojnë të destabilizojnë vendin dhe të ofrojnë më shumë hapësirë për ndikimet e huaja malinje. Narrativet dezinformuese e thellojnë polarizimin tashmë ekzistues në shoqërinë maqedonase dhe ndikojnë negativisht në proceset shoqërore, siç është procesi i integritimit evropian. Dezinformimet nuk janë vetëm një problem informues, por edhe një problem sigurie, ndaj lufta kundër tij kërkon një qasje ndërdisiplinore.

HULUMTIMI I OPINIONIT PUBLIK

QËLLIMET E HULUMTIMIT TË OPINIONIT PUBLIK

Për të mundësuar procesin e përfaqësimit dhe nxitjes së ndryshimit të duhur të politikave mediatike, në tetor të vitit 2023 u zbatua një hulumtim i opinionit publik, me ndihmën e të cilit u analizuan pozicionet dhe qëndrimet e popullatës në Maqedoninë e Veriut lidhur me çështjen e përhapjes së dezinformatave, interesin për ndryshimin e politikave dhe ndikimin e burimeve të huaja dhe vendore të dezinformimit në kontekstin e integritetit në NATO dhe BE, si dhe ndjeshmërinë e tyre ndaj formave të ndryshme të ndikimeve të huaja malinje.

Për t'u kuptuar më mirë efektet e narrativeve dezinformuese gjatë vitit të kaluar, respektivisht për të vlerësuar ndikimin e tyre në ndryshimin e qëndrimeve të qytetarëve në lidhje me temat me interes në hulumtim, është bërë një analizë krahasuese me rezultatet e fituara nga hulumtimi i opinionit publik të kryer në vitin paraprak 2022. Një analizë e tillë ndihmoi edhe në vlerësimin e efekteve pozitive të aktiviteteve në lidhje me verifikimin e fakteve në media, si dhe në miratimin e rekomandimeve për masat që duhet të ndërmerren nga institucionet relevante shtetërore për të penguar në mënyrë proaktive operacionet e ndikimeve të huaja malinje në vend.

ANALIZA E REZULTATEVE NGA HULUMTIMI I OPINIONIT PUBLIK

PËRHAPJA E DEZINFORMATAVE


Për zhvillimet dhe ngjarjet brenda dhe jashtë vendit qytetarët më së shumti informohen nga stacionet televizive vendore - 62% informohen nga stacionet televizive vendore çdo ditë, kurse 24% disa herë në javë. Në të njëjtën kohë, popullata e moshuar është e informuar në masën më të madhe nga stacionet televizive vendore. Një tjetër kanal informimi më i shpeshtë janë mediat sociale - 58% e qytetarëve informohen nga mediat sociale çdo ditë, ndërsa 16% të paktën disa herë në javë. Këtu hulumtimi tregon se këto dy media të shpeshta të informacionit janë të përfaqësuara në mënyrë të ndryshme në grupmoshat e ndryshme të popullsisë. Kanalet televizive vendore janë mediumi dominues i informacionit për popullatën e moshuar. Përkatësisht, 81% e popullsisë së moshës 65+, 77% e popullsisë së moshës 50-64 dhe 52% e popullsisë së moshës 30-49 vjeç informohen çdo ditë nga stacionet televizive vendore. Mediat sociale, nga ana tjetër, janë kanali dominues i informacionit për popullatën e re. Kështu, nga mediat sociale çdo ditë informohen madje 77% e qytetarëve të moshës prej 18deri 49 vjet.

Hulumtimi tregon se informimi përmes kontakteve dhe komunikimeve personale ka shënuar rritje enorme gjatë vitit të kaluar. Nëse vitin e kaluar 36% e qytetarëve informoheshin çdo ditë për ngjarjet dhe zhvillimet përmes komunikimit të drejtpërdrejtë në marrëdhëniet e tyre personale, dhe 35% e kontakteve personale informoheshin disa herë në javë, këtë vit vërehet një frekuencë jashtëzakonisht e rritur. Rreth 64% e qytetarëve janë prononcuar se informohen çdo ditë përmes kontakteve personale, dhe 22% të tjerë kanë konfirmuar se informohen përmes kontakteve personale të paktën disa herë në javë.

Rritje të ndjeshme krahasuar me vitin e kaluar ka shënuar edhe informimi nga portalet e internetit. Këtë vit, rreth 51% e qytetarëve kanë konfirmuar se informohen nga portalet e internetit çdo ditë (kundër 37% vitin e kaluar), kurse 18% e qytetarëve, pra njësoj si vitin e kaluar, kanë konfirmuar se informohen nga portalet e internetit disa herë brenda javës.

Një rritje e vogël është vërejtur edhe në përdorimin e radios si medium për informim - vitin e kaluar 13% e kanë nënvizuar këtë medium si burim ditor të informacionit, ndërsa këtë vit kjo përqindje është 18%. Gjithashtu, vitin e kaluar 11% janë informuar nga radio disa herë në javë, ndërsa këtë vit kjo përqindje është 20%.

Sa shpesh informoheni përmes kanaleve të informimit në vazhdim?




Hulumtimi tregon se qytetarët kanë pak besim në informacionet që i marrin nga kanale të ndryshme informative. Besimi në mediat tradicionale (stacionet televizive, radio dhe mediat e shtypura) është më i lartë në krahasim me atë të shfaqur në mediat digjitale. Kështu, 39% e qytetarëve u besojnë plotësisht ose deri diku stacioneve televizive vendase, 30% u besojnë stacioneve televizive nga vendet fqinje, 21% u besojnë stacioneve televizive ndërkombëtare, 38% u besojnë radio stacioneve, kurse 27% besojnë në mediat e shtypura.

Analiza krahasuese e rezultateve në krahasim me vitin e kaluar tregon rënie të besimit në mediat tradicionale, dhe rritje të besimit në mediat digjitale. Kështu, besimi në portalet e internetit është rritur nga 27% sa ishte vitin e kaluar në 30% këtë vit. Gjithashtu, besimi në mediat sociale është rritur nga 21% vitin e kaluar në 26% këtë vit.


Ashtu si vitin e kaluar, edhe këtë vit hulumtimi tregoi se qytetarët kanë besimin më të lartë në informacionet e marra përmes kontakteve personale – deri në 62% e qytetarëve u besojnë informacioneve të marra përmes kontaktit personal.

Sa u besoni këtyre mediave/burimeve të informimit?




Shumica e qytetarëve (84%) janë të vetëdijshëm se dezinformatat paraqesin një problem serioz në vendin tonë. Vetëm 11% nuk pajtohen me këtë pohim.

A mendoni se dezinformatat, respektivisht lajmet e rreme, paraqesin problem serioz në vendin tonë?




Madje 57% e qytetarëve kanë deklaruar se të paktën një herë në javë, në mediat nga të cilat informohen, vërejnë informacione që pasqyrojnë në mënyrë të gabuar apo të pasaktë realitetin. Kjo përqindje është ulur ndjeshëm në krahasim me vitin e kaluar, kur madje 69% e qytetarëve deklaruan se të paktën një herë në javë vërejnë informacione të pasakta në mediat nga të cilat informohen. Ky ndryshim mund të jetë për shkak të aktiviteteve të intensifikuara në fushën e verifikimit të fakteve gjatë vitit të kaluar, si rezultat i së cilës është vërejtur një rënie e frekuencës së narrativeve të dezinformatave në portalet e internetit vitin e kaluar, si dhe intensifikimit të punës së autoriteteve vetërregulluese në vend.

Sa shpesh vëreni informacione në mediat nga të cilat informoheni që e paraqesin realitetin në mënyrë të pasaktë apo të gabuar?




Përqindja më e madhe e qytetarëve besojnë se kanë një shkallë të mjaftueshme të edukimit mediatic dhe se janë të aftë t'i identifikojnë lajmet e rreme ose dezinformatat nga mediat nga të cilat marrin informacione. 31% e qytetarëve janë shumë të sigurt dhe 48% janë disi të sigurt se mund të njohin dezinformimin e mediave. Gjatë kësaj, qytetarët me arsim të lartë kryesisht besojnë se kanë një shkallë të lartë të edukimit mediatic - 40% e tyre besojnë se janë shumë të sigurt, respektivisht 48% se janë disi të sigurt në aftësinë e tyre për të njohur lajmet e rreme ose dezinformatat në mediat. Në mesin e qytetarëve me arsim të mesëm, këto përqindje janë më të ulëta - 29% janë shumë të sigurt, dhe 48% janë disi të sigurt. Përqindjet më të ulëta janë matur te qytetarët me arsim fillor. Vetëm 11% e tyre deklaruan se janë të sigurt dhe 39% se janë disi të sigurt në aftësinë e tyre për të njohur lajmet e rreme apo dezinformatat në mediat nga të cilat informohen.

Sa jeni të sigurt në aftësinë tuaj për të dalluar lajmet e rreme ose dezinformatat në media nga të cilat informoheni?



Numri më i madh i qytetarëve (52%) konsiderojnë se vetëm gjatë një jave në mediat nga të cilat janë informuar vërejnë përdorimin e lajmeve të rreme për të diskredituar një organizatë, parti, shtet apo të ngjashme. 42% e qytetarëve kanë deklaruar se vërejnë storje krejtësisht të trilluara për qëllime dhe agjenda politike të caktuara, dhe pothuajse 40% e qytetarëve në mediat nga të cilat informohen vërejnë storje në të cilat ka fakte të shtrembëruara për të arritur agjendën e dikujt. 27% deklaruan se gjatë një jave hasin në një storje gazetareske të përpiluar keq në mediat për të cilat informohen.

Nëse gjatë javës së kaluar, në mediat nga të cilat informoheni, keni hasur në:




INTERESI PËR NDRYSHIME TË POLITIKËS

Pothuajse gjysma e qytetarëve (46%) konsiderojnë se niveli i dezinformatave që i hasin në media është aq i madh sa duhet bërë diçka për ta ulur atë. Kundrejt kësaj, 28% e qytetarëve mendojnë se niveli i dezinformatave nuk është aq i madh sa për t'u ndërmarrë masa të caktuara për reduktimin e tij. Është indikative se më shumë se një e katërta e qytetarëve (26%) nuk kanë mendimin e tyre për këtë çështje.

Pothuajse një e treta e qytetarëve (31%) konsiderojnë se dezinformatat në media dhe në rrjetet sociale janë dukuri negative, por pasojat janë shumë të vogla. Kundrejt kësaj, 40% nuk janë pajtosh me këtë qëndrim dhe konsiderojnë se pasojat e dezinformatave në media dhe në rrjetet sociale nuk janë të vogla. Ky qëndrim është më i përhapur te popullata me arsim të lartë (51%), më pak te popullata me arsim të mesëm (36%) dhe më së paku te popullata me arsim të ulët (24%). Përsëri, është indikative se rreth 29% e qytetarëve janë të dëshpëruar dhe nuk kanë qëndrim të tyre lidhur me këtë çështje.

Megjithatë, madje tre të katërtat e qytetarëve (75%) pajtohen me pohimin se dezinformatat duhet të sanksionohen me ligj.

Sa pajtoheni me deklaratat në vazhdim?




Hulumtimi tregon se qytetarët e kuptojnë mirë natyrën e dezinformatave dhe qëllimet e përhapjes së tyre nëpër sferën mediatike. Kështu, rreth 75% e qytetarëve konsiderojnë se dezinformatat e inkurajojnë gjuhën e urrejtjes dhe ndarjet në shoqëri. Madje 51% e qytetarëve pajtohen plotësisht me këtë qëndrim, kurse 24% deri diku.

Madje 68% e qytetarëve pajtohen se dezinformatat paraqesin kërcënim për sigurinë dhe se janë po aq të rrezikshme sa format e tjera të luftës speciale: sulmet kibernetike, alarmet false për bomba. Në të njëjtën kohë, 43% pajtohen plotësisht dhe 25% deri diku pajtohen me këtë qëndrim.

Më shumë se gjysma e qytetarëve (55%) konsiderojnë se dezinformatat janë mjet i liderëve dhe regjimeve jodemokratike dhe autoritare, kurse 48% vlerësojnë se alarmet e rreme me bomba në shkolla, qendra tregtare dhe institucione me të cilat është përballur shoqëria jonë në periudhën e kaluar janë organizuar jashtë kufijve të vendit tonë.

Hulumtimi tregon se shumica e qytetarëve (pothuajse 40%) vlerësojnë se shteti nuk ka kapacitet për t'u përballur me kërcënimet nga dezinformatat dhe format e tjera të luftës speciale, ndërsa një përqindje dukshëm më e vogël (vetëm 27%) kanë mendim të kundërt dhe vlerësojnë se shteti ka kapacitet për të luftuar kundër dezinformatave. Madje 26% e qytetarëve nuk kanë mbajtur qëndrim për këtë çështje.


Deri në çfarë shkalle pajtoheni me deklaratat në vazhdim?



Qytetarët konsiderojnë se dezinformatat, në masë më të madhe, i përhapin politikanët dhe gazetarët, gjegjësisht mediat. Rreth 89% e qytetarëve vlerësojnë se politikanët përhapin dezinformata, ndërsa 85% mendojnë se gazetarët, respektivisht mediat, përhapin dezinformata. Këtu, mediat sociale dhe portalet e internetit janë renditur në rend të parë. Madje 81% e qytetarëve janë prononcuar se dezinformatat përhapen përmes portaleve të internetit dhe të mediave sociale.

Organizatrat joqeveritare janë burim i dezinformatave sipas 54% të qytetarëve, kurse korporatat, respektivisht organizatat e biznesit sipas 51% të qytetarëve.

Përmes cilëve nga këto subjekte përhapen dezinformatat në vend?




Një përqindje e madhe e qytetarëve konsiderojnë se dezinformatat përhapen edhe përmes shërbimeve të ndryshme diplomatike në vendin tonë. Kështu, madje 55% e qytetarëve vlerësojnë se dezinformatat përhapen përmes shërbimeve diplomatike të vendeve fqinje, 50% përmes shërbimeve diplomatike të SHBA-ve dhe 49% përmes diplomacisë së BE-së.

Lidhur me hulumtimin e opinionit publik nga viti i kaluar, këtë vit është rritur përqindja e qytetarëve që vlerësojnë se shërbimet diplomatike të Federatës Ruse po përhapin dezinformata në vend. Vitin e kaluar, 46% e qytetarëve besonin se diplomacia e Federatës Ruse përhap dezinformata në vend, ndërsa këtë vit kjo përqindje është 49%.


Sipas qytetarëve, dezinformatat përhapen edhe përmes institucioneve akademike dhe shkencëtarëve (41%), si dhe përmes institucioneve arsimore vendore. Sa u përket institucioneve arsimore vendore, hulumtimi tregon rritje: nëse vitin e kaluar 37% e qytetarëve kanë konsideruar se këto institucione përhapin dezinformata, këtë vit kjo përqindje është rritur në 43%.

Përmes cilëve nga këto subjekte përhapen dezinformatat në vend?



Më shumë se tre të katërtat e qytetarëve (rreth 86%) konsiderojnë se qeveria duhet të ndërmarrë masa për t'u përballur me dezinformatat në media.

Sipas mendimit tuaj, a duhet Qeveria të ndërmarrë masa për zgjidhjen e problemit me dezinformatat në media?




Për të përballuar me sukses me dezinformatat, është e nevojshme të ndërmerren aktivitete dhe masa të ndryshme. Në këtë drejtim, 82% e qytetarëve konsiderojnë se është e rëndësishme që gazetaret t'u përmbahen standardeve profesionale dhe të jenë të kujdesshëm për vërtetësinë e lajmeve që i publikojnë dhe po aq (82%) vlerësojnë se në media duhet të raportohet vazhdimisht për ndikimin e dëmshëm nga dezinformatat dhe lajmet e rreme.

80% e qytetarëve konsiderojnë se për një luftë të suksesshme kundër dezinformatave, është e nevojshme të rritet niveli i ndërgjegjësimit të qytetarëve për ekzistimin e dezinformatave dhe lajmeve të rreme në media, ndërsa 76% janë pajtuar me masa konkrete që i referohen promovimit të edukimit mediatic dhe qasjes kritike ndaj informatave në media. 67% mendojnë se qytetarët duhet të kontrollojnë vetë besueshmërinë e informacioneve në media.


79% e qytetarëve e konsiderojnë të rëndësishëm miratimin e një ligji për mbrojtjen nga dezinformatat në media dhe 68% e qytetarëve e shohin zgjidhjen në ekzistimin e një organizate të pavarur që do të merret me verifikimin e fakteve në media.

Sa është e rëndësishme secila nga këto masa?




Më shumë se dy të tretat, respektivisht 68% e qytetarëve konsiderojnë se portalet duhet të jenë të barabarta në status juridik me mediat e tjera dhe të funksionojnë si media me të njëjtat përgjegjësi ligjore. Vetëm 15% nuk janë pajtuar me këtë qëndrim.

Sipas jush, a duhet që portalet të jenë të barabarta në statusin juridik me mediat e tjera dhe të funksionojnë si media me të njëjtat përgjegjësi juridike?



Për dallim nga viti i kaluar, hulumtimi vëren një rritje të ndërgjegjësimit të qytetarëve për përgjegjësinë që kanë portalet ndaj lexuesve të tyre. Vitin e kaluar, një përqindje e lartë (74%) e qytetarëve kanë vlerësuar se portalet kanë përgjegjësi për të mbrojtur lexuesit e tyre nga dezinformatat, kurse këtë vit kjo përqindje është rritur në 79%. Është specifike se ndërgjegjësimi për përgjegjësinë e portaleve është më i ulët te popullata më e re e moshës 18–29 vjeç (77% besojnë se portalet kanë përgjegjësinë për të mbrojtur lexuesit nga dezinformatat), krahasuar me popullsinë më të moshuar - 87% e popullsisë së moshës 30–49 vjeç dhe 81% e popullsisë së moshës prej 50 deri 64 vjet vlerësojnë se portalet kanë përgjegjësinë për të mbrojtur lexuesit nga dezinformatat. Po ashtu, popullata me arsimim më të ulët ka më pak gjasa të kërkojë përgjegjësi nga portalet - 59% e qytetarëve me arsim të ulët besojnë se portalet kanë përgjegjësi për dezinformatat. Kjo përqindje është më e lartë në mesin e popullatës me arsim të mesëm (76%), dhe më e larta në mesin e popullatës me arsim të lartë (89%). Qytetarët e komunitetit tektonik shqiptar janë në një shkallë shumë më të lartë të vetëdijshëm për përgjegjësinë e portaleve në aspektin e dezinformatave (85%), për dallim nga qytetarët e komunitetit etnik maqedonas ku kjo përqindje është 76%.


A vlerësoni se portalet online kanë përgjegjësi për t'i mbrojtur lexuesit e tyre nga dezinformatat?



Ndonëse është vërejtur një rënie e caktuar në përqindje në raport me hulumtimin e vitit të kaluar, edhe në hulumtimin e këtij viti pjesa më e madhe e qytetarëve vlerësojnë se rolin kryesor në uljen e efekteve negative të dezinformatave në media duhet ta kenë institucionet përgjegjëse për krijimin e politikave mediatike (64% vitin e kaluar dhe 59% këtë vit), si dhe vetë mediat, respektivisht gazetarët (64% vitin e kaluar dhe 58% këtë vit). Një faktor i tretë kyç janë politikanët (39% vitin e kaluar dhe 41% këtë vit).

Hulumtimi i sivjetshëm vëren një ndryshim në qëndrimin e qytetarëve në lidhje me rolin e disa palëve të tjera të përfshira. Nëse vitin e kaluar 31% e qytetarëve kanë vlerësuar se mediat sociale duhet të luajnë një rol udhëheqës në uljen e efekteve të dezinformatave, kjo përqindje është rritur në 35% këtë vit. Gjithashtu, hulumtimi vëren një rritje të dukshme të pritjeve të shoqatave joformale të qytetarëve, për të cilat vitin e kaluar 12% e qytetarëve kanë besuar se duhet të kenë rol udhëheqës në luftën kundër dezinformatave dhe këtë vit kjo përqindje është rritur në 17%. Roli i organizatave joqeveritare vlerësohet i njëjtë me vitin e kaluar (14%), ndërkohë që u vu re një rritje e lehtë e pritjeve nga institucionet akademike (18% vitin e kaluar, dhe 20% këtë vit mendojnë se institucionet akademike duhet të kenë një rol udhëheqës në reduktimin e efekteve të dezinformatave).

Sipas Jush, cilët nga këto subjekte duhet të kenë rol udhëheqës në reduktimin e efekteve negative të dezinformatave në media?




NDIKIMI I BURIMEVE TË HUAJA DHE VENDORE TË DEZINFORMATAVE

Teoritë e konspiracionit

Hulumtimi tregoj se qytetarët, në një masë të madhe, janë të ndjeshëm ndaj dezinformatave dhe teorive konspirative.

Vitin e kaluar u mat se 71% e qytetarëve besojnë se ekziston një grup i fshehtë individësh të fuqishëm në botë që kontrollojnë ngjarjet globale, si luftërat dhe krizat ekonomike. Edhe pse këtë vit kjo përqindje ka rënë ndjeshëm, është matur një përqindje e lartë prej 62% e qytetarëve që kanë ende të njëjtin besim. Gjithashtu, një përqindje e madhe e qytetarëve ende besojnë se COVID-19 është krijuar qëllimisht, në mënyrë që fuqitë botërore të përfitojnë ekonomikisht dhe politikisht. Këtë besim e kanë pasur 66% e qytetarëve këtë vit, që do të thotë se është edhe më e theksuar në krahasim me vitin e kaluar kur kjo përqindje ishte 64%.

Sa besoni në secilën nga këto deklaratat?




Hulumtimi i sivjetshëm tregon edhe ndryshim të qëndrimit të qytetarëve në lidhje me informacionet lidhur me ndryshimet klimatike. Nëse vitin e kaluar vetëm 24% e qytetarëve besonin se ndryshimet klimatike nuk ekzistojnë, por janë trilluar për të kontrolluar ekonominë, këtë vit kjo përqindje është rritur në 36%.

Gjurmët e bardha nga avionët në qiell janë dëshmi se po na spërkasin me helme, është narrativ që besojnë 39% e qytetarëve (kundër 36% që nuk e pranojnë si të vërtetë).

Një përqindje më e madhe e qytetarëve (41%) nuk e pranojnë si të vërtetë narrativin anti-vaksinim, sipas të cilit sëmundjet për të cilat bëhet vaksinimi nuk janë serioze dhe mund të tejkalohen me imunitet natyror (29% e qytetarëve besojnë në të vërtetën e këtij narrativi). Megjithatë, një përqindje e madhe e qytetarëve (49%) konsiderojnë se vaksinat e rregullta për fëmijët janë të sigurta, krahasuar me vetëm 14% që mendojnë krejtësisht të kundërtën. Duhet theksuar se një përqindje e lartë (37%) nuk kanë qëndrim të tyre për këtë çështje.

Sa besoni në secilën nga këto deklaratat?



NDIKIMI I NARRATIVEVE TË DEZINFORMATAVE PRO-RUSE

Mendimi se Rusia ka një forcë më të madhe ushtarake se NATO-ja ende mbizotëron te qytetarët. Vitin e kaluar, 43% e qytetarëve kishin këtë besim, krahasuar me 18% që besonin krejtësisht të kundërtën. Edhe pse hulumtimi i këtij viti tregon një ndryshim në qëndrimet e qytetarëve për këtë çështje (37% besojnë se Rusia ka një forcë më të madhe se NATO-ja, krahasuar me 21% që nuk besojnë), mund të thuhet se te qytetarët mbizotëron qëndrimi se Rusia ka një forcë më të madhe ushtarake sesa NATO-ja.


Numri më i madh i qytetarëve në vend (49%) besojnë se lufta në Ukrainë është në të vërtetë një luftë midis Rosisë dhe NATO-s. Kjo përqindje është më e lartë te qytetarët me arsim të lartë (50%), krahasuar me qytetarët me arsim të mesëm (44%) dhe qytetarët me arsim të ulët (35%).

Rreth 39% e qytetarëve besojnë se në Ukrainë ka laboratorë amerikanë për krijimin e armëve biologjike. Ky narrativ është dukshëm më i përhapur te komuniteti etnik maqedonas (43%) në krahasim me komunitetin etnik shqiptar (27%).

Gjithashtu, përqindja e qytetarëve që besojnë se Rusia po udhëheq luftën kundër nazizmit në Ukrainë është më e lartë. Madje 31% e qytetarëve e ndajnë këtë besim, kundrejt 26% që e hedhin poshtë këtë besim si të pavërtetë.


Edhe pse shumica e qytetarëve (43%) nuk e arsyetojnë sulmin rus ndaj Ukrainës, një përqindje e lartë, madje 21% besojnë se sulmi rus ndaj Ukrainës është i justifikuar. Në të njëjtën kohë, kjo është më e përhapur te komuniteti etnik maqedonas (24% mendojnë se sulmi rus ndaj Ukrainës është i justifikuar), dhe më pak i përhapur te komuniteti etnik shqiptar, ku kjo përqindje është 14%.

Sa besoni në secilën nga këto deklaratat?



17% e qytetarëve besojnë se ka burime dhe etnitete në vend që i promovojnë interesat ruse. Në të njëjtën kohë, ky qëndrim është më i përhapur te popullata me arsim të lartë (28%), për dallim nga popullsia me arsim të mesëm (14%) dhe popullsia me arsim të ulët në të cilën vetëm 3% besojnë se ka burime dhe etnitete në vend që i promovojnë interesat ruse. Kundrejt tyre, 30% besojnë se nuk ka etnitete të tilla në vend. Madje 50% e qytetarëve nuk kanë qëndrim të tyre për këtë çështje.


Sipas njohurive të Juaja, a ka burime/entitete që i promovojnë interesat dhe qëndrimet ruse në vend?



Ashtu si vitin e kaluar, qytetarëve të anketuar që besojnë se ka subjekte në vend që i promovojnë në mënyrë aktive interesat ruse, u ishte kërkuar që t'i specifikojnë ato etnitete. Për dallim nga viti i kaluar, kur në përqindje më të lartë përmendeshin shërbimet sekrete të vendeve të tjera (11%), mediat (10%) dhe partitë politike (9%), këtë vit në përqindjen më të lartë u përmend partia politike E Majta. 15% e qytetarëve që konsiderojnë se interesat ruse po promovohen në vend besojnë se interesa të tilla po promovohen përmes Të Majtës. Kjo shënon një ndryshim të rëndësishëm në opinione në krahasim me vitin e kaluar, kur vetëm 4% e qytetarëve që besonin se interesat ruse promovohen në mënyrë aktive në vend përmendën Të Majtën si burimin e këtyre interesave.

Personalitetet publike (9%), politikanë të caktuar (7%), media të caktuara (5%) dhe kisha (5%) janë renditur gjithashtu si etnitete që i promovojnë interesat ruse në vend.

Cilat burime/entitete i promovojnë interesat dhe qëndrimet ruse në vend? N=191




Narrativet anti-europiane, respektivisht pro-ruse ende e formojnë kryesisht opinionin publik në vend. Në të njëjtën kohë, hulumtimi tregon se ata kanë një ndikim dukshëm më të madh te qytetarët e përkatësisë etnike maqedonase, kundrejt qytetarëve të përkatësisë etnike shqiptare. Kështu, 35% e qytetarëve besojnë se një aleancë me një fuqi të madhe sllave dhe ortodokse si Rusia (që do të ishte një alternativë e integritit euroatlantik) është më e dobishme për vendin tonë, krahasuar me 26% të qytetarëve që nuk pajtohen me këtë pikëpamje. Prirja drejt Rusisë në këtë kontekst është më e theksuar te qytetarët e komunitetit etnik maqedonas (37% konsiderojnë se aleanca me Rusinë është e dobishme, kundrejt 23% që nuk pajtohen me këtë pikëpamje). Në mesin e qytetarëve nga komuniteti etnik shqiptar, një përqindje e lartë (30%) pajtohen se aleanca me Rusinë është e dobishme për vendin, kundrejt 35% që nuk pajtohen me këtë pikëpamje.

Madje 50% e qytetarëve besojnë se aleanca me Rusinë dhe blerja e gazit rus më të lirë do të ishte me rëndësi vendimtare për përmirësimin e ekonomisë së vendit tonë. Sërish, ky qëndrim është më i theksuar te qytetarët nga komuniteti etnik maqedonas, ku 53% pajtohen dhe 10% nuk pajtohen me qëndrimin e deklaruar, për dallim nga qytetarët nga komuniteti etnik shqiptar ku 39% pajtohen me qëndrimin e deklaruar dhe 27% nuk pajtohen.

Një përqindje e lartë (42%) e qytetarëve mendojnë se vendosja e sanksioneve ndaj Rusisë, në kontekst të luftës në Ukrainë, nuk është një politikë e mirë për vendin tonë. Ky qëndrim dallon dukshëm te qytetarët nga komuniteti etnik maqedonas dhe ai shqiptar. Derisa 53% e qytetarëve të përkatësisë etnike maqedonase besojnë se sanksionet kundër Rusisë nuk janë një politikë e mirë (12% besojnë se ato janë një politikë e mirë), vetëm 9% e qytetarëve të përkatësisë etnike shqiptare besojnë se sanksionet kundër Rusisë nuk janë një politikë e mirë, kundrejt 47% që pajtohen se sanksionet kundër Rusisë janë një politikë e mirë e vendit tonë.

Opinionet janë të ndara edhe për politikën e vendit tonë ndaj Ukrainës: derisa 35% e qytetarëve mendojnë se vendi ynë duhet të vazhdojë të mbështesë sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës në luftën me Rusinë, 23% e qytetarëve mendojnë pikërisht të kundërtën. Kjo ndarje në qëndrime është shprehur te qytetarët e përkatësisë etnike maqedonase, ku 27% mendojnë se vendi ynë duhet të mbështesë sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, kundrejt 29% që mendojnë pikërisht të kundërtën. Ndryshe nga ata, qëndrimi dominues i qytetarëve nga komuniteti etnik shqiptar është se vendi ynë duhet të vazhdojë të mbështesë pavarësinë dhe sovranitetin e Ukrainës (60% e qytetarëve nga komuniteti etnik shqiptar pajtohen me këtë qëndrim, kundrejt 6% që nuk pajtohen).

Në çfarë shkalle pajtoheni se:



MARRËDHËNIET GJEOPOLITIKE TË MAQEDONISË SË VERIUT


Presioni politik në vend për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me Bullgarinë, përmes narrativeve të pranishme të informacionit në media gjatë vitit të kaluar solli në një ndryshim të caktuar të qëndrimeve të qytetarëve. Kështu, vitin e kaluar madje 60% e qytetarëve mendonin se vendi duhet të bëhet anëtar i BE-së, por pa lëshime me Bullgarinë dhe këtë vit kjo përqindje ka rënë në 48%. Nga ana tjetër, vitin e kaluar 19% besonin se vendi duhet t'i bënte lëshime Bullgarisë për të aderuar me sukses në BE, kurse këtë vit kjo përqindje u rrit në 26%.

Megjithatë, hulumtimi tregon se madje 50% e qytetarëve nuk pajtohen me idenë e ndryshimit të Kushtetutës me qëllim të anëtarësimit në BE, ku 42% nuk pajtohen me këtë ide dhe 8% deri diku nuk pajtohen. Lidhur me këtë çështje, hulumtimi tregon një dallim të madh në qëndrimet e komunitetit etnik maqedonas dhe atij shqiptar. Përderisa vetëm 13% e qytetarëve me përkatësi etnike maqedonase pajtohen për ndryshimin e kushtetutës (9% plotësisht dhe 4% deri diku pajtohen), madje 68% e qytetarëve me përkatësi etnike shqiptare pajtohen për ndryshimin e kushtetutës (50% plotësisht dhe 18% deri diku pajtohen).

Qytetarët kanë mendime të ndara në lidhje me ndikimin në vlerat shoqërore që do të sjellë anëtarësimi në BE. 39% konsiderojnë se anëtarësimi në BE do të çojë në humbjen e vlerave tradicionale të familjes, dhe një përqindje më e vogël prej 31% nuk pajtohen me këtë pikëpamje. Madje 20% e qytetarëve nuk kanë mendimin e tyre për këtë çështje. Për më tepër, sipas të dhënave të hulumtimit, komuniteti etnik maqedonas është shumë më i shqetësuar se komuniteti etnik shqiptar për ndikimin e BE-së në vlerat tradicionale familjare. Përderisa 43% e qytetarëve me përkatësi etnike maqedonase besojnë se anëtarësimi në BE do të çojë në humbjen e vlerave tradicionale familjare, te qytetarët me përkatësi etnike shqiptare kjo përqindje është dukshëm më e ulët (26%).

Zhvillimet politike gjatë vitit të kaluar, si dhe narrativet dezinformuese që i shoqëruan ato në media, padyshim ndikuan në rritjen e skepticizmit euroatlantik te qytetarët. Kështu, vitin e kaluar 40% e qytetarëve kanë deklaruar se ndiheshin më të sigurt pas anëtarësimit të vendit në NATO dhe këtë vit kjo përqindje ka rënë në 30%.

Në çfarë shkalle pajtoheni se:



.Ndikim më pozitiv në vendin tonë ka politika e Serbisë fqinje. Madje 83% e qytetarëve e ndajnë këtë mendim (89% e qytetarëve të përkatësisë etnike maqedonase dhe 66% e qytetarëve të përkatësisë etnike shqiptare). Kjo përqindje shënon rritje të ndjeshme krahasuar me vitin e kaluar kur ishte 73%. Një tjetër vend që ka ndikim pozitiv në vendin tonë, sipas opinionit të qytetarëve, është Turqia. Rreth 66% e qytetarëve (89% e qytetarëve të përkatësisë etnike maqedonase dhe 66% e qytetarëve të përkatësisë etnike shqiptare) mendojnë se Turqia ka ndikim pozitiv në vendin tonë, që shënon rritje të përqindjes, sepse vitin e kaluar ishte 62%.

Pikëpamjet në lidhje me ndikimin e SHBA-ve janë të ndara. Gjegjësisht, vitin e kaluar 43% e qytetarëve mendonin se SHBA-të kanë ndikim pozitiv, ndërsa 38% mendonin se kishin ndikim negativ në vendin tonë. Këtë vit, përqindja e qytetarëve që ndajnë një opinion pozitiv për SHBA-të është ulur, kështu që 39% besojnë se SHBA-të kanë ndikim pozitiv, ndërsa 37% mendojnë se kanë ndikim negativ në vendin tonë. Qëndrimet në lidhje me ndikimin e SHBA-ve ndryshojnë në mënyrë drastike në mesin e qytetarëve të përkatësisë etnike maqedonase dhe asaj shqiptare. Përderisa mendimi se SHBA-të kanë ndikim negativ në vendin tonë dominon te qytetarët e përkatësisë etnike maqedonase (46% - ndikim negativ, kundrejt 31% - pozitiv), te qytetarët nga komuniteti etnik shqiptar, hulumtimi tregon gjetje të kundërta (66% - ndikim pozitiv, kundrejt 10% - ndikim negativ).

Hulumtimi vëren një ndryshim të rëndësishëm në qëndrimet ndaj Ruisë. Vitin e kaluar, 40% e qytetarëve mendonin se Rusia kishte një ndikim pozitiv, dhe një përqindje më e vogël (27%) mendonin se kishte një ndikim negativ në vendin tonë. Këtë vit, hulumtimi vë në dukje një ndryshim të rëndësishëm në qëndrime. Kështu, derisa 34% janë ende të mendimit se Rusia ka një ndikim pozitiv, një përqindje më e madhe e qytetarëve (38%) deklarojnë se Rusia ka ndikim negativ në vendin tonë. Ndërkohë, derisa qytetarët me përkatësi etnike maqedonase janë të ndarë në pikëpamjet e tyre për ndikimin e Ruisë (38% - ndikim pozitiv, kundër 32% - negativ), një përqindje më e madhe e qytetarëve të përkatësisë etnike shqiptare (59%) besojnë se Rusia ka një ndikim negativ në vendin tonë, kundrejt një përqindje më të vogël (21%) që mendojnë të kundërtën.

Edhe pse një numër i madh i qytetarëve (më shumë se 40%) nuk kanë një qëndrim të qartë për ndikimin e Kinës në vendin tonë, mund të vërehet se qytetarët besojnë se Kina ka një ndikim pozitiv dhe ky qëndrim shënon një rritje nga viti i kaluar në këtë vit. Vitin e kaluar 36% e qytetarëve deklaruan se Kina ka një ndikim pozitiv në vendin tonë dhe këtë vit kjo përqindje është rritur në 43%.


Bullgaria ka ndikimin më negativ në vendin tonë, sipas mendimit të qytetarëve - 77% e qytetarëve në hulumtimin e vitit të kaluar, përkatësisht 78% në hulumtimin e sivjetshëm, besojnë se Bullgaria ka ndikim negativ në vendin tonë. Këtë qëndrim kryesisht e ndajnë qytetarët me përkatësi etnike maqedonase (81%) dhe qytetarët e përkatësisë etnike shqiptare (65%).

Një tjetër vend fqinj që ka një ndikim negativ dominues është Greqia. Këtë mendim e ndajnë 54% e qytetarëve (hulumtimi tregon një rënie në krahasim me vitin e kaluar kur kjo përqindje ishte 61%). Në raport me Greqinë, ka dallime të theksuara ndërmjet qytetarëve të përkatësisë etnike maqedonase dhe asaj shqiptare. Përderisa për 62% të qytetarëve të përkatësisë etnike maqedonase Greqia ka ndikim negativ (për 19% ka ndikim pozitiv), te qytetarët e përkatësisë etnike shqiptare qëndrimet janë të ndara (32% - ndikim pozitiv, 30% - ndikim negativ).

54% e qytetarëve (53% vitin e kaluar) konsiderojnë se Kosova ka ndikim negativ në vendin tonë, dhe 28% se ka ndikim pozitiv. Në raport me këtë shtet fqinj, hulumtimi vë në dukje dallimin më të madh në qëndrimet e qytetarëve të përkatësisë etnike shqiptare dhe maqedonase. Përderisa 77% e qytetarëve të përkatësisë etnike shqiptare besojnë se Kosova ka një ndikim pozitiv në vendin tonë (8% besojnë se ka ndikim negativ), qytetarët e përkatësisë etnike maqedonase kanë pikëpamje krejtësisht të kundërt - 66% vlerësojnë se Kosova ka një ndikim negativ kundrejt 13% që mendojnë se Kosova ka ndikim pozitiv.

Qëndrimet për ndikimin e Shqipërisë janë të ndara, me një rritje të ndjesive negative vitin e fundit. Vitin e kaluar, 36% e qytetarëve mendonin se Shqipëria kishte një ndikim negativ, por 35% e qytetarëve kanë vlerësuar se kishte një ndikim pozitiv në vendin tonë. Këtë vit, përqindja e qytetarëve që konsiderojnë se Shqipëria ka ndikim pozitiv ka mbetur pothuajse e njëjtë (34%), por përqindja e qytetarëve që e konsiderojnë ndikimin e Shqipërisë si negativ është rritur ndjeshëm (46%). Sa i përket qëndrimeve për ndikimin e Shqipërisë, ka dallime të theksuara ndërmjet qytetarëve të përkatësisë etnike maqedonase dhe asaj shqiptare. Gjegjësisht, përderisa 76% e qytetarëve të përkatësisë etnike shqiptare besojnë se Shqipëria ka ndikim pozitiv në vendin tonë (përkundërt 5% që besojnë se ka ndikim negativ), qëndrimi i qytetarëve të përkatësisë maqedonase është i ndryshëm - 59% besojnë se Shqipëria ka ndikim negativ, kundrejt 19% që konsiderojnë se Kosova ka ndikim pozitiv.


Çfarë ndikimi ka në vendin tonë:



Nga të gjitha vendet fqinje, Serbia vlerësohet si mikja më e madhe e vendit tonë. Rreth 71% e qytetarëve janë prononcuar se Serbia është mikja më e madhe dhe kjo përqindje shënon rritje në krahasim me vitin e kaluar kur ishte 66%. Lidhur me këtë çështje, ka dallim në qëndrimet e qytetarëve nga komunitetet etnike maqedonase dhe shqiptare. Për qytetarët e komunitetit etnik maqedonas, Serbia është i vetmi shtet fqinj mik (85% e qytetarëve të përkatësisë etnike maqedonase e ndajnë këtë pikëpamje), ndërsa për qytetarët e përkatësisë etnike shqiptare, vendi ynë ka tre vende mike – Shqipërinë (29%), Serbinë (27%) dhe Kosovën (12%).

Nga të gjitha vendet fqinje, sipas qëndrimit të qytetarëve, armikja më e madhe e Maqedonisë së Veriut është Bullgaria. Madje 56% e qytetarëve e ndajnë këtë pikëpamje. Në lidhje me këtë çështje, hulumtimi nuk vëren dallim në qëndrimet e qytetarëve të përkatësisë etnike maqedonase dhe asaj shqiptare - 58% e qytetarëve të përkatësisë etnike maqedonase, përkatësisht 49% e qytetarëve të përkatësisë etnike shqiptare, konsiderojnë se Bullgaria është armikja më e madhe e vendit tonë. Krahasimi me hulumtimin e qëndrimeve të qytetarëve nga viti i kaluar vëren rritje të sentimentit negativ ndaj Bullgarisë - vitin e kaluar 50% e qytetarëve mendonin se Bullgaria ishte armikja më e madhe e vendit tonë, ndërsa këtë vit kjo përqindje është rritur në 56%.

Cili vend fqinj është miku më i madh i Maqedonisë së Veriut?



Cili vend fqinj është armiku më i madh i Maqedonisë së Veriut?



REKOMANDIME

Si rezultat i procesit hulumtues dhe i analizës së të dhënave, i japim këto rekomandime të përgjithshme:

- Nevojitet një qasje sistematike për ndërtimin e një kulture të opinionit kritik dhe dialogut shoqëror në të gjitha nivelet, duke filluar me një rol proaktiv të institucioneve shtetërore në nivelin e ndërtimit të politikave publike, duke rritur cilësinë e mbulimit mediatic të temave të nxehta, ndërsa edukimi digjital dhe mediatic duhet të përforcohet si përmes sistemit arsimor dhe përmes programeve arsimore në media, ashtu edhe përmes reformimit të marrëdhënieve ndërmjet institucioneve dhe palëve të interesuara nga të gjithë sektorët, si dhe në të gjitha nivelet.
- Përdorimi i zgjeruar i mediave online, nga portalet e internetit e deri te rrjetet sociale, të cilat qytetarët i konsiderojnë ndër burimet kryesore të dezinformatave, e imponon nevojën për zgjidhjen e problemeve të shtresuara që lidhen me mungesën e rregullimit në këtë fushë, nëpërmjet ndryshimit dhe plotësimit të ligjeve dhe rregulloreve me qëllim ruajtjen dhe avancimin e lirisë së shprehjes, në përputhje me standardet e BE-së.
- Nevojitet ngritja e nivelit të integritetit të mediave përmes duke e shtuar respektimin e standardeve profesionale dhe etike në gazetari, si dhe duke e shtuar aplikimin e dukshmërisë së mekanizmeve të vetërregullimit. Mediat duhet të vendosin mekanizma të brendshëm që do të rrisin rezistencën e tyre ndaj dezinformatave, përmes vendosjes së procedurave për verifikimin e fakteve, dhe në nivel të politikave redaktuese të kenë prioritet raportimin proaktiv për rrjedhat e dezinformatave, së bashku me promovimin e edukimit mediatic dhe atij digjital.
- Mediat duhet të angazhohen për transmetimin e përmbajtjeve të verifikuara nga shërbimet e verifikimit të fakteve ose media të tjera, si dhe nga organizatat civile që zbulojnë rregullisht dezinformata dhe narrative dezinformuese në kuadër të aktivitetit të tyre.
- Niveli i ulët i besimit në institucionet e sistemit demokratik, nga njëra anë te Qeveria dhe te organet në përbërje të saj, si dhe mediat si shtyllë e demokracisë, dhe nga ana tjetër në vetëdijen e shprehur civile për dëmin e dezinformatave, e ndjekur nga kërkesa për zgjidhjen e situatës, i jep përparësi nevojës për një qasje sistematike, duke filluar me krijimin e një strategjie shtetërore për të forcuar rezistencën ndaj efekteve të dëmshme të dezinformatave, përmes një procesi gjithëpërfshirës që do t'i marrë parasysh edhe të gjitha përvojat e mëparshme për të tejkaluar polarizimin.
- Është e nevojshme të ngrihet niveli i debatit publik për kontekstin gjeopolitik, rrjedhën e dezinformatave, burimet e tyre dhe interesat që i promovojnë, veçanërisht tendencat antidemokratike që lidhen me ndikimet nga regjimet e huaja autoritare. Institucionet shtetërore, komuniteti akademik, respektivisht komuniteti shkencor-arsimor, mediat dhe shoqëria civile kanë detyrimin që në mënyrë më proaktive t'i informojnë qytetarët për situatën përmes narrativeve pozitive të bazuara në fakte përmes përmbajtjeve informative dhe edukative, debateve publike të bazuara në hulumtime gazetareske dhe analizave profesionale.
- Rezultatet e hulumtimit vënë në pah se ekziston ende një ndjeshmëri e lartë ndaj teorive të konspiracionit dhe narrativeve të tjera alternative, që është pasojë e faktorëve strukturorë dhe presionit të vazhdueshëm dhe përhapjes së dezinformatave përmes disa mediave, e veçanërisht përmes rrjeteve sociale. Gjendja e këtillë duhet të adresohet me programe konkrete të bazuara në bashkëpunimin mes të gjithë subjekteve shoqërore, në vend të patologjizimit apo praktikave të politizimit, refuzimit apo injorimit.
- Duke marrë parasysh polarizimin e lartë në shoqëri në shumë drejtime, dhe veçanërisht paragjykimet lidhur me përkatësinë politike dhe rezistencën ndaj qasjes shkencore në mjekësi, gjatë përgatitjes së ndërhyrjeve kundër dezinformatave, është e rëndësishme që të merren vendime bazuar në të dhënat nëse në një situatë të caktuar është efektive për të aplikuar një qasje konfrontative (përmes së cilës mund të forcohet polarizimi), ose të përpiqet, nëpërmjet një dialogu social të gjerë dhe gjithëpërfshirës, t'u japë një shans të gjitha palëve që të rishqyrtojnë disa nga vlerat, perceptimet dhe mendimet e tyre.
- Krijuesit e opinionit publik duhet të kenë parasysh se mungesa e informimit dhe e debatit të qëndrueshëm publik çon në zbrazëtira informative që u japin hapësirë ndikimeve të jashtme malinje për të vepruar mbi perceptimin e qytetarëve me synimin për të rënuar demokracinë. Prandaj është e rëndësishme që identifikimi dhe rishqyrtimi i narrativeve dezinformuese të bëhet pjesë integrale e të gjitha formave të komunikimit publik dhe krijimit të përmbajtjeve.

- ✎ Institucionet shtetërore dhe publike, kompanitë private dhe organizatat e shoqërisë civile duhet t'i sendërtojnë kodet etike me synimin për të përfshirë luftën kundër dezinformatave si vlerë thelbësore dhe zhvillimin e mëtejshëm të procedurave dhe kritereve të përshtatshme të punës për veprim gjatë proceseve të prokurimit të shërbimeve mediatike.
- ✎ Të gjitha institucionet, dhe veçanërisht ato në fushën e shëndetësisë, t'i mbështesin mediat, shërbimet, organizatat që punojnë drejtpërdrejt për zbulimin e dezinformatave në lidhje me temat shëndetësore (veçanërisht për epidemitë dhe vaksinimin), përmes promovimit të përmbajtjes së krijuar në profilet e tyre në rrjetet sociale dhe faqet e internetit.
- ✎ Institucionet shtetërore nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv duhet të marrin një rol më proaktiv në përforcimin e kapaciteteve financiare të mediave profesionale, si dhe në krijimin e një mjedisi të favorshëm për investime financiare në industrinë mediatike, ndërkohë që përmirësimi i situatës me mediat duhet të trajtohet si qëllim strategjik.
- ✎ Organizatat civile duhet të vazhdojnë me krijimin dhe akumulimin e njohurive në lidhje me problemin e dezinformatave, veçanërisht me iniciativat për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për efektet e dëmshme të dezinformatave dhe metodat e ndërtimit të rezistencës ndaj tyre që do të mbulojnë grupe të ndryshme të synuara nga komunitetet e tyre për të cilat do të përcaktojnë se ata janë më të ndjeshëm ndaj ndikimit negativ të dezinformatave, veçanërisht popullata e re dhe e moshuar.

ANEKSI: METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

METODOLOGJIA E MONITORIMIT TË NARRATIVEVE DEZINFORMUESE NË MEDIA

Ky raport ofron një pasqyrë të rezultateve të procesit të monitorimit të mediave vendase online nga janari deri në shtator 2023. Qëllimi i këtij monitorimi ishte identifikimi dhe analizimi i tendencave të dezinformatave në lidhje me ndikimet e huaja malinje në vend dhe për të kuptuar mesazhet kryesore që ata synojnë të dërgojnë. Për të arritur këtë qëllim, ekipi i Metamorfosis analizoi më shumë se 400 artikuj nga media të ndryshme dhe postime në rrjete sociale, për të cilat dyshohej se përmbanin dezinformata në lidhje me ndikimet e huaja në vend. Përzgjedhja e artikujve është bërë në bazë të disponueshmërisë së fakteve të verifikuara që mund të kontrollohen me metoda profesionale gazetareske, ku gjatë këtij aktiviteti janë përfshirë edhe artikujt me përfaqësim të lartë në rrjetet sociale. Analiza e kryer mbi këta artikuj mbuloi disa aspekte kryesore, duke përfshirë mesazhin e dezinformatave që ato synojnë të përcjellin, temat dhe narrativet me të cilat lidhen, nivelin e tyre të ndikimit, burimet e origjinës, shpërndarjen mediatike dhe potencialin e tyre për të provokuar dhunë ose radikalizëm.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT TË OPINIONIT PUBLIK

Për realizimin e hulumtimit është përdorur metodologjia kuantitative e kërkimit. Teknika e mbledhjes së të dhënave përbëhej nga zbatimi i anketës telefonike (CATI) me ndihmën e kompjuterit, online nëpërmjet një platforme të specializuar për këtë lloj kërkimi. Me ndihmën e programit softuerik SPSS (IBM SPSS Statistics Program) të dhënat janë përpunuar me metodën e statistikave përshkruese.

Për arritjen e objektivave të hulumtimit u përgatit një pyetësor prej 37 pyetjeve të llojit të mbyllur dhe të hapur.

Për të verifikuar logjikën dhe qartësinë e pyetjeve, pyetësori u testua me një hulumtim pilot në 10% të totalit të mostrave, pas së cilës pasuan korrigjime shtesë të natyrës teknike.

Për qëllimet e këtij hulumtimi u përdor metodologjia hulumtuese kuantitative e mostrës reprezentative të ndarë në më shumë nivele. Sipas strukturës gjeodemografike të popullatës, Maqedonia e Veriut është e ndarë në tetë rajone: i Shkupit, i Pollogut, i Pelagonisë, i Vardarit, Verilindor, Juglindor, Jugperëndimor dhe Lindor, në komunitete urbane dhe rurale. Numri i të anketuarve është proporcional me numrin e përgjithshëm të popullsisë në çdo rajon.

Mostra kryesore përmban 1100 amvisëri: Çdo amvisëri është e përfaqësuar nga një i anketuar në moshë mbi 18 vjet.

Në hulumtim u përfshinë gjithsej 34 komuna, duke përfshirë zonat urbane dhe rurale, të përzgjedhura në mënyrë përfaqësuese nga të tetë rajonet statistikore të vendit. Puna në terren u realizua nga data 20 tetor deri më 1 nëntor të vitit 2023.

Gabimi statistikor për hulumtimet e këtij lloji është +/-3%, që është një devijim normal për këtë mostër reprezentative.

DEMOGRAFIA E TË ANKETUARVE

		%	N
Gjinia	Mashkullore	49,4%	543
	Femërore	50,6%	557
Grupmosha	18-29 vjet	14,4%	158
	30-49 vjet	38,3%	421
	50-64 vjet	26,7%	294
	65+ vjeç	20,6%	227
	Refuzon të përgjigjet	0,0%	0
Arsimimi	Pa arsim/Pa arsim fillor të kryer	1,0%	11
	Arsim fillor	5,8%	64
	Arsim të mesëm trevjeçar	3,8%	42
	Arsim të mesëm	59,8%	658
	Të lartë	7,5%	82
	Sipëror, Mr., Dr.	21,8%	240
	Refuzon të përgjigjet	0,3%	3
Përkatësia etnike	Maqedonas/e	73,5%	809
	Shqiptar/e	23,6%	260
	Serb/e	0,5%	5
	Vlleh/e	0,6%	7
	Turk/e	0,7%	8
	Rom/e	0,6%	7
	Boshnjak/e	0,4%	4
	Tjetër	0,0%	0
Statusi i punës	I punësuar në sektorin privat	42,8%	471
	I punësuar në sektorin shtetëror	13,7%	151
	Në institucion ndërkombëtar	0,3%	3
	Në sektor joqeveritar	0,4%	4
	I papunë	9,2%	101
	Nxënës/Student	4,5%	49
	Amvise	0,6%	7
	Privat/pronar biznesi	2,6%	29
	Honorar	0,7%	8
	Pensionist	22,9%	252
	Bujk	2,3%	25
	Tjetër	0,0%	0
Vendi i banimit	Qytet	67,2%	739
	Fshat	32,8%	361
Rajoni	I Vardarit	7,4%	81
	Lindor	8,7%	96
	Jugperëndimor	11,5%	126
	Juglindor	8,4%	92
	I Pellagonisë	10,0%	110
	I Pollogut	15,4%	169
	Verilindor	8,3%	91
	I Shkupit	30,5%	335

